REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

R A P O R T

Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (SHKB)

Viti 2011

Fjala hyrëse e Ministrit të Brendshëm Z. Bujar NISHANI

Raporti Vjetor i SHKB-së për vitin 2011, është një dokument që i ofrohet publikut në lidhje me veprimtarinë njëvjecare të këtij institucioni të rëndësishëm të Ministrisë së Brendshme. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm ka si mision ligjor të realizojë një mbikqyrje të drejtë policore, që garantohet nëpërmjet pavarësisë së tij, pasi është një mekanizëm i jashtëm për Policinë e Shtetit dhe nuk varet prej saj.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë të gjitha angazhimet e saj legjislative, organizative dhe financiare që t'i garantojë publikut një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent.

Krahas reformave që ka ndërmarrë vete Policia e Shtetit, që kanë ndikuar në rritjen e performancës së saj, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe SHKB-ja në këtë drejtim, duke ndikuar drejtpërdrejtë në integritetin e punonjësve që është elementi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e këtij shërbimi.

Një përpjekje e madhe është bërë gjatë këtyre viteve për të kontrolluar korrupsionin në sektorët e administratës publike dhe në veçanti në Policinë e Shtetit, për shkak të vetë specifikës së misionit të këtij institucioni. Eshtë jetike që në një shoqëri demokratike fenomeni i rrezikshëm i korrupsionit të mos gjejë hapësira në institucionet që merren me zbatimin e ligjit.

Masat e ndërmarra kundër këtij fenomi të rrezikshëm për shoqërinë e sotme janë të gjithashme. Krahas goditjes së këtij fenomeni, një rëndësi të vecantë merr aplikimi i masave me karakter parandalues, të cilat SHKB-ja, gjatë vitit 2011 i ka përdorur gjerësisht. Një ndër këto masa mjaft të rëndësishme ka qenë inspektimi i strukturave të ndryshme policore, me qëllim matjen e performancës së punës së tyre.

Procedurat konkurruese, të drejta dhe transparente që aplikohen në bazë të ligjit për përzgjedhjen e personelit që punon në SHKB, trajnimi i vazhdueshëm i tyre dhe mbështetja që i kanë dhënë partnerët ndërkombëtarë SHKB-së, sidomos ICITAP dhe OSCE, kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve tek ky institucion, që gjë e tregon numri i ankesave që publiku ka paraqitur pranë këtij institucioni.

Ministria e Brendshme dhe Qeveria Shqiptare, do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të garantuar mbështetje maksimale për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, me qëllim që të përmbushë me sukses mision e saj ligjor.

Gjej rastin që të garantojë publikun se SHKB-ja do të vazhdojë të kryej mision e saj në mbrojtjen të interesave të ligjshme të qytetarëve kur pretendohet se ato preken nga veprimet e paligjshme të punonjësve të caktuar të Policisë së Shtetit.

Ju ftoj të vazhdoni të bashkëpunoni me SHKB-në, në luftën kundër korrupsionit.

Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së
Z. Astrit HALILAJ

Viti 2011, ka qenë një vit plot angazhime për të gjithë punonjësit e organizatës sonë, për përmbushjen e objektivave strategjike të SHKB-së, të përcaktuara në Programin e Punës për vitin 2011, objektiva të cilat kanë qenë të përcaktuara dhe në Planin e Veprimit 3-vjeçar, 2011-2013, ***"Për zbatimin e Stratëgjisë Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente",*** si dhe në Planin e Veprimit për zbatimin e 12 rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian, në kuadrin e proceseve integrues për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Evropian.

Objektivat në këto dokumente strategjikë, ishin si udhërrëfyes për punën një-vjecare të SHKB-së, të cilat janë zbatuar me korrektësi nga të gjitha strukturat tona, në nivel qëndror dhe vendor.

Në aspektin administrativ, gjatë vitit u miratua Vendimi i Qeverisë, "***Për disa të drejta financiare të punonjësve të SHKB-së***" dhe Rregullorja e Brendshme e shërbimit. Miratimi i Rregullores do të ndikojë ndjeshëm në organizimin e punës dhe në disiplinimin e saj.

Gjithashtu janë draftuar dy akte të tjera të rëndësishme nënligjore, që kanë karakter operacional dhe priten të miratohen nga Ministri dhe Prokurorja e Përgjithshme. Këto akte do të shërbejnë si instrumente të rëndësishme për veprimtarinë operacionale të SHKB-së. Një sërë aktesh të tjera, që kanë të bëjnë me procedurat standarte të punës, inspektimet e jashtëzakonshme etj, po hartohen, duke përfunduar të gjitha aktet nënligjore që rregullojnë të gjithë veprimtarinë e SHKB-së. Këto akte do të ndikojnë ndjeshëm në performancën e punës tonë, duke e bërë SHKB-në, një Instuticion të Administrates Publike, më të besueshëm për qytetarët dhe për vet Policinë e Shtetit.

Në veprimtarinë operacionale, SHKB-ja, mbështet punën në tre shtylla të rëndësishme që përfaqësojnë drejtimet kryesore të saj.

Shtylla e parë, ka të bëjë me gjurmimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, pavarësisht nga funksioni dhe grada që mbajnë, duke garantuar publikun se askush në Policinë e Shtetit nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë ligjore nëse ndaj tij, ka dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale. Nisur nga ky parim shumë i rëndësishëm për punën tonë, gjatë vitit 2011, kemi hetuar dhe dërguar për ndjekje penale pranë Organit të Prokurorisë, **135**

oficer policie, të niveleve e shërbimeve të ndryshme, nga punonjësi i nivelit zbatues e deri në Drejtor i Policisë së Qarkut, ku **22** prej tyre janë arrestuar.

Theksojmë, se gjatë hetimeve janë përdorur me sukses teknikat dhe mjetet speciale më bashkohore. SHKB-ja i ka të gjitha kapacitetet teknike dhe profesionale për të zhvilluar hetime profesionale sado të vështira të jenë ato. Personeli është trajnuar me praktikat më të mira ndërkombëtare, falë edhe bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerët tanë ndërkombëtarë, në mënyrë të veçantë ICITAP dhe OSBE.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe shoqërinë civile ka qenë i mirë.

Shtylla e dytë, ka të bëjë me Inspektimet në Policinë e Shtetit. Gjatë vitit 2011, SHKB-ja ka zhvilluar **21** inspektime, në Drejtoritë e Policive të Qarkut, Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore dhe Drejtoritë Rajonale të Kufirit & Migracionit. Nëpërmjet këtyre inspektimeve ne kemi matur performancën e punës së strukturave të Policisë së Shtetit, me qëllim që të përmbushet misioni "***për një Shërbim Policor të përgjegjshëm dhe transparent në një shoqëri demokratike***". Konkluzionet dhe rekomandimet tona i janë përcjellë menaxherëve më të lartë të Policisë së Shtetit për ndërmarrjen e masave përkatëse për zbatimin e tyre. Në përmbushje të misionit tonë do të vazhdojmë të kryejmë inspektime të tjera, për të verifikuar nëse i ka zbatuar policia rekomandimet e SHKB-së.

Përveç performancës për efektivitetin dhe efiçencën e Policisë së Shtetit, do të fokusojmë punën tonë edhe në mbikqyrjen e Policisë së Shtetit, nëse gjatë ushtrimit të kompetencave të saja, respektohen të drejtat dhe liritë themelore të individit, gjatë shoqërimit, arrestimit/ndalimit dhe trajtimit në ambjente policore, të drejta këto të garantuara nga Kushtetuta, Aktet Ndërkombëtare dhe Ligjet.

Shtylla e tretë, por jo më pak e rëndësishme, ka të bëjë me marrjen, shqyrtimin dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit. Për shkak të kompetencave që ligji i jep policisë në një shtet demokratik,të cilat në disa raste kanë të bëjnë dhe me kufizimin e të drejtave të qytetarëve, që mund të bëhen edhe objekt konflikti. Eshtë në misionin e SHKB-së, që t'i garantojë publikut një shërbim policor të përgjegjshëm dhe demokratik. Çdo ankesë ndaj policisë duhet të merret dhe të hetohet me objektivitet dhe paanësi. Autorizimet që ligji i jep policisë, nuk duhet të shpërdorohen.

Ndërhyrja në jetën private duhet të bëhet vetëm për një qëllim të ligjshëm dhe për interes publik. Përdorimi i forcës nga policia duhet të jetë proporcionale dhe e nevojshme për të përmbushur një detyrim ligjor. Gjatë vitit 2011, kemi marrë dhe hetuar shumë ankesa ndaj policisë, të cilat në disa raste, kanë shërbyer edhe si shkak, për të filluar ndjekje penale dhe disiplinore.

SHKB-ja, ka krijuar të gjithë infrastrukturën e duhur për marrjen e ankesave të qytetarëve, nëpërmjet linjës jeshile telefonike pa pagesë, internetit, shërbimeve postare, paraqitjes personalisht në zyrat tona etj. Do të vazhdojmë marrëdhëniet e bashkëpunimit me

qytetarët, duke i garantuar që të kenë besim tek SHKB-ja dhe të denonçojnë çdo sjelle të keqe të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Policia në punën e saj, udhëhiqet nga filozofia e policimit në komunitet, por edhe vet punonjësit e policisë janë pjesë e këtij komuniteti.

Ne realizojmë mbikqyrjen për t'u garantuar qytetarëve se kemi një shërbim policor të përgjegjshëm, transparent dhe demokratik, dhe punojmë për të rritur besimin tek Policia e Shtetit përmes përmbushjes së misionit tonë dhe duke bashkëpunuar me të, për përmbushjen e misionit të saj ligjor, për garantimin e rendit, sigurisë publike dhe zbatimin korrekt të ligjit.

FALËNDERIME

Falënderojmë qytetarët që kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar SHKB-në në përmbushjen e misionit të saj ligjor.

Falënderojmë të gjithë punonjësit e SHKB-së, që me përkushtim dhe profesionalizëm punojnë për përmbushjen e objektivave të organizatës sonë.

Falënderojmë punonjësit dhe menaxherët e Policisë së Shtetit, të cilët kanë asistuar SHKB-në për kryerjen e detyrave të saj ligjore.

Shprehim mirënjohje për mbështetjen që na ka dhënë Ministri i Brendshëm në përmbushjen e objektivave strategjike të SHKB-së.

Falënderojmë për bashkëpunimin të gjitha agjencitë e tjera ligjzbatuese.

Falënderojmë të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë: ICITAP, PAMECA dhe OSBE, të cilët kanë asistuar nga afër punën tonë duke na këshilluar me praktikat më të mira Euro-Atlantike, si dhe kanë bërë të mundur zhvillimin e një cikli trajnimesh për personelin hetues dhe inspektues të SHKB-së.

Falënderojmë homologët tanë Evropianë, anëtarë të EPAC (Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit).

Falënderojmë të gjithë ata që japin kontributin e tyre për të luftuar korrupsionin dhe shkeljet e tjera të ligjit në Policinë e Shtetit.

Falënderojmë grupin e punës të cilët hartuan këtë dokument, që është një instrument i rëndësishëm në funksion të trasparencës të punës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

SHKURTIME

KE	Komisioni Evropian
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DPQ	Drejtoria e Policisë së Qarkut
NJRPRR	Njësia Rajonale e Policisë Rrugore
DRKM	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
EPAC	Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit
RAI	Iniciativa Rajonale Antikorrupsion
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit të Krimeve
ILDKP	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
ITAP	Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike
MB	Ministria e Brendshme
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian
PAMECA	Misioni i Ndihmës Policore të Komunitetit Evropian për Shqipërinë
PSH	Policia e Shtetit
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
TIA	Transparenca Ndërkombëtare për Shqipëri
PKMZSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

PASQYRA E LËNDËS

Fjala hyrëse e Ministrit të Brendshëm **1**

Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së **2**

Falënderime **6**

Shkurtime **7**

Përmbledhje mbi Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm **9**

Organizimi aktual, rekrutimet e personelit dhe trajnimet **10**

Buxheti i vitit 2011 dhe realizimi i tij **16**

Veprimtaria Hetimore **17**

Trajtimi i ankesave të shtetasve për punonjës të Policisë së Shtetit **23**

Bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në PSH **26**

Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimeve **27**

Konkluzione **38**

Objektiva për SHKB-në **39**

Si do të matet realizimi i objektivave të SHKB-së **40**

Rekomandime për Policinë e Shtetit **41**

Si mund të na kontaktoni **42**

Hyrje

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, si një agjenci mbikqyrëse dhe strukturë hetimore kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, punon për të përmbushur misionin e saj, që ti garantojë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent.

Edhe gjatë vitit 2011, SHKB-ja ka vazhduar të orientohet nga vizioni i Qeverisë shqiptare, për ***reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje***, duke e vënë theksin në dy nga drejtimet kryesore në luftën ndaj këtij fenomeni:

- Parandalimin e tij;
- Ndëshkimin administrativ dhe penal të zyrtarëve të korruptuar (punonjësët e Policisë së Shtetit).

Ky vizion është i lidhur ngushtësisht me zbatimin e objektit të veprimtarisë së SHKB-së:

a) Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj.

b) Inspektimi i punës së të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre.

1. ORGANIZIMI AKTUAL I SHKB-SË

Edhe gjatë vitit 2011, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, ka qenë i organizuar si Drejtori e Përgjithshme, me struktura në nivel qëndror e vendor, me numër të personelit 92 punonjës të ndarë në:

- personel hetues -**78** punonjës
- personel inspektues - **10** punonjës
- personel mbështetës - **4** punonjës

Drejtoria e Përgjithshme përfshin **Departamentin e Hetimit**, **Drejtorinë e Inspektimit** dhe **Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse**.

Departamenti i Hetimit ku përfshihen:

- Drejtoria e Hetimit & Testi i Integritetit, ndarë në tre sektorë drejtimi.
- Sektori i Analizës, zyra e kartotekës dhe zyra e ankesave dhe informacionit.
- Sektori i Veprimeve Operacionale.
- Drejtoria e SHKB-së për Tiranën.
- 11 sektorët e SHKB-së në Qarqe.

Personeli i këtij departamenti ka ushtruar kompetencat hetimore me qëllim, "***zbulimin, dokumentimin, goditjen dhe hetimin paraprak të veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada***".

Drejtoria e Inspektimeve, ka ushtruar kompetencat për inspektimin e strukturave të Policisë së Shtetit, ***për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre.***

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, gjatë këtij viti është përpjekur të menaxhojë sa më mirë burimet njerëzore, buxhetin dhe të sigurojë mbështetjen logjistike të SHKB-së.

2. REKRUTIMET E PERSONELIT NË VITIN 2011

Gjatë këtij viti, bazuar në procedurat e përcaktuara në ligjin e SHKB-së dhe Rregulloren e Personelit, nëpërmjet konkursit janë përzgjedhur e më pas emëruar në detyrë gjithsej **9 (nëntë)** punonjës, nga të cilat **4 (katër)** në trupën operacionale dhe **5 (pesë)** në Drejtorinë e Hetimit.

Për **5** (pesë) pozicionet e lira në Drejtorinë e Hetimit, aplikuan **9** persona, nga të cilat u përzgjodhën dhe fituan 5 prej tyre.

Trajnimet e personelit

Në zbatim të programit të vitit 2011 u trajnuan:

- **34** punonjës të Departamentit të Hetimeve me temën "Mbi hetimin bazë", organizuar nga ICITAP/OSBE, zhvilluar në Qendrën e Formimit Policor.

Grupi i parë datë 31.01.2011 – 25.02.2011

Grupi i dytë datë 04.04.2011 – 29.04.2011

- **15** punonjës të SHKB-së (personel inspektues dhe hetues) të cilët morën pjesë në seminarin me temë "Lufta kundër korrupsionit në radhët e Policisë së Shtetit", organizuar nga ambasada franceze në Tiranë, nga data 20 – 21 Qershor 2011, nën drejtimin e 2 ekspertëve francezë të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimeve.

Pjesmarje në programe e aktivitete ndërkombëtare

- Pjesëmarrja e **2** punonjësve të SHKB-së nga data 21 Shkurt – 11 Mars 2011, në Programin e Vizitorëve Ndërkombëtarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me temë "Përgjegjësia në qeverisje".

- Pjesëmarrja e **1** punonjësi të SHKB-së nga data 04-25 Qershor 2011, në Programin e Vizitorëve Ndërkombëtarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me temë "Lufta ndaj krimit ndërkombëtar".

- Pjesëmarrja e SHKB-së në dy mbledhje pune në datat 7 dhe 9 Qershor, me anëtarët e grupeve ndërinstitucionale për kapitujt 23 dhe 24, për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit(PKMZSA).

- Pjesëmarrja e SHKB-së në Konferencën e EPAC (Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit) me temë "Standardet Evropiane të anëtarëve të EPAC/EACN", në datat 13-14 Prill 2011, në Budapest, Hungari.

ALBANIA

eu
Hungarian Presidency
of the Council of
the European Union
EPAC

- Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së në Francë nga data 11-14 Maj 2011, në kuadër të bashkëpunimit teknik dypalësh ndërmjet agjencive homologe.

- Pjesëmarrja e SHKB-së në Konferencën e dytë Rajonale të Njësive të Kontrollit të Brendshëm, me temë "Metodologjia e zbulimit të korrupsionit dhe bashkëpunimi i Shërbimeve të Kontrollit të Brendshëm në rajon për të parandaluar korrupsionin", financuar nga ICITAP/OSBE, nga data 12-14 Qershor 2011, Ohër, Maqedoni.

3. BUXHETI I VITIT 2011, REALIZIMI I TIJ

Planifikimi në fillim të vitit 2011

- Buxheti total **120,766,096 lekë.** Nga këto:

  - ✓ Paga dhe shpenzime personeli **87,614,096 lekë.**
  - ✓ Sigurime shoqërore **12,614,000 lekë.**
  - ✓ Mallra e shërbime **15,780,000 lekë**.
  - ✓ Transferuar për buxhetet familjare **2,108,000 lekë.**
  - ✓ Investime **2,650,000 lekë.**

Realizimi në fund të vitit 2011

- Buxheti total **119,314,056 lekë,** ose **99%.** Nga këto:

  - ✓ Paga dhe shpenzime personeli **86,372,281 lekë,** ose **99%.**
  - ✓ Sigurime shoqërore **12,612,822 lekë,** ose **100%.**
  - ✓ Mallra e shërbime **15,635,441 lekë,** ose **99%.**
  - ✓ Transfertat për buxhetet familjare **2,108,000 lekë** ose **100%.**
  - ✓ Investime **2,585,512 lekë** ose **98%.**

4. VEPRIMTARIA HETIMORE

SHKB-ja gjatë vitit 2011 ka referuar për ndjekje penale në Prokurori **101** çështje, në ngarkim të **135** punonjësve të policisë dhe **9** shtetasve, nga të cilët, **3** punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues, **39** punonjës policie të nivelit të parë drejtues dhe **93** punonjës policie të nivelit zbatues. Nga numri i përgjithshëm, **20** punonjës policie dhe **2** shtetas janë arrestuar në flagrancë.

Tabela përmbledhëse e hetimeve të kryera nga SHKB-ja për vitin 2011

viti	Lloji i veprës penale	Nr. kallëzimeve	Nr. subjekteve	Nivelet				Arrestuar/ Punonjës policie/shtetas	
				Mesëm drejtues	Parë drejtues	zbatues	shtetas		
2011	Vepra korruptive	63	94	3	28	63	8	11	1
	Veprime arbitrare	21	25	-	7	18	-	6	-
	Vepra te tjera	17	16	-	4	12	1	3	1
	Totali	101	135	3	39	93	9	20	2

Paraqitja grafike e hetimeve të kryera ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2011





Tabela përmbledhëse e hetimeve për vitin 2011 nga strukturat e SHKB-së

Nr.	Drejtoria/Sektorë të SHKB-së në qarqe	Nr. Kallëzimeve penale	Nr. Punonjësëve të policisë	Sipas nivelit të gradave		
				Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues
1.	Tirana	14	18	-	9	9
2.	Gjirokastra	17	23	-	6	17
3.	Korça	9	14	-	3	11
4.	Fieri	12	20	-	5	15
5.	Durrësi	8	9	-	2	7
6.	Berati	3	3	-	1	2
7.	Elbasani	4	6	-	3	3
8.	Vlora	2	2	-	-	2
9.	Dibra	5	12	-	2	10
10.	Lezha	8	5	-	-	5
11.	Kukësi	1	3	-	-	3
12.	Shkodra	5	6	1	2	3
13.	Drejtoria e Hetimit	13	14	2	6	6
14.	Totali	101	135	3	39	93

Paraqitja grafike e hetimeve për vitin 2011 nga strukturat e SHKB-së dhe e numrit të punonjësve të policisë të kallëzuar për ndjekje penale



Hetime të suksesshme gjatë vitit 2011

- ✓ **Procedimi penal**, në ngarkim të **1** punonjësi të policisë**,** me gradën **Nënkomisar,** me detyrë specialist për hetimin e krimeve, i hetuar për veprën penale të "Falsifikim dokumenti shkollor" parashikuar nga neni 187/1 i Kodit Penal, pasi siguronte dokumente të falsifikuara për persona të tjerë. U bë arrestimi i tij në bazë të vendimit të gjykatës dhe çështja është në gjykim.

- ✓ **Procedimi penal,** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë, me gradën **Nënkomisar** me detyrë, Shef i Stacionit Policor, për veprën penale të "Vjedhjes" kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim. Është arrestuar me vendim të gjykatës dhe çështja është në gjykim.

- ✓ **Procedimi penal,** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë, me gradën **Nënkomisar**, me detyrë Specialist i Parandalimit të Krimit dhe Policimit në Komunitet, për veprën penale të "Korrupsionit pasiv", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Pas një pune hetimore disa mujore ku u aplikuan metodat speciale te hetimit, në bazë të vendimit të gjykatës u bë arrestimi i tij, sëbashku me një shtetas, i cili u akuzua për veprën penale të "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi 2. Aktualisht kjo çështje është në hetim.

- ✓ **Procedimi penal,** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë, me gradën **Inspektor**, me detyrë, punonjës i patrullës së përgjithshme, për veprën penale të "Korrupsionit pasiv", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Gjatë hetimit të kësaj çështje u aplikuan metodat speciale të hetimit dhe me vendim gjykate u bë arrestimi i tij. Çështja është në gjykim.

- ✓ **Procedimi penal** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë me gradën **Nënkomisar**, me detyrë, Komandant i patrullës së përgjithshme në Komisariat, referuar për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Nga hetimi i kësaj çështje kanë rezultuar të implikuar në veprimtari kriminale edhe **4 punonjës** të tjerë të Policisë së Shtetit, efektiv të strukturave të tjera policore si dhe rreth 30 shtetas. Aktualisht kjo çështje është në hetim.

- ✓ **Procedimi penal** në ngarkim të **9** punonjësve të policisë rrugore, me gradën **Inspektorë**, për veprën penale të "Korrupsionit pasiv", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Hetimet e kësaj çështje kanë filluar mbi bazën e ankesave të disa shtetasve. Çështja është në hetim.

- ✓ **Procedimi penal** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë, me gradën **Nënkomisar**, me detyrë, Specialist për hetimin e parandalimin e krimit, referuar për veprën penale të, "Shfrytëzimit të prostitucionit" parashikuar nga nenet 114/a pika 2 dhe 6 i KP. Pas një pune disa mujore dhe aplikimit të metodave speciale u bë arrestimi i tij në flagrancë. Aktualisht kjo çështje është në gjykim.

- ✓ **Procedimi penal** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë kufitare, me gradën **Nënkomisar,** kallëzuar për veprën penale të "Korrupsionit pasiv". Pas një pune disa mujore duke përdorur të gjitha teknikat dhe metodat speciale të hetimit, si vëzhgime, filmime, fotografime, simulimi i aktit korruptiv, u bë e mundur arrestimi në flagrancë. Aktualisht kjo çështje është në hetim.

- ✓ **Procedimi penal** në ngarkim të **2** punonjësve të policisë, njëri me gradën **Drejtues,** për veprën penale të, "Korrupsionit pasiv", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe tjetri me gradën **Inspektor**, me detyrë, trupe shërbimi, referuar për veprën penale, "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, si dhe **1** shtetas, referuar për veprën penale "Korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal.

- ✓ **Procedimi penal,** në ngarkim të **1** punonjësi të policisë, me gradën **Drejtues dhe** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Policisë së Qarkut, referuar për veprën penale të, "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën", në bashkëpunim me **1** shtetas, parashikuar nga nenet 135 e 25 te Kodit Penal. Aktualisht kjo çështje është në hetim.

- ✓ **Procedimi penal**, ne ngarkim te **1** punonjësi policie të nivelit të parë drejtues dhe **3 shtetasve**, për veprën penale të, "Korrupsionit", në bashkëpunim, duke favorizuar një grup të strukturuar kriminal. Aktualisht kjo çështje është në hetim.

Tabela me të dhëna për referimet e veprave penale sipas viteve.

Nr. Referimeve sipas veprave penale	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Mesatarja për 6 vite	Rënia apo zvogëlimi i fenomenit në % krahasuar me vitin 2006
Vepra korruptive	112	85	72	56	57	63	74.1	43.75%
Veprime arbitrare	35	42	38	35	11	21	30,3	40%
Vepra te tjera	38	32	54	22	13	17	29,3	55.26%

Të dhënat e paraqitura në grafik për periudhën 6 vjeçare, tregojnë tendencë rënie në masën 43.75% për vepra korruptive, 40% për vepra arbitrare dhe 55.26% për vepra të tjera penale.



Tabela me të dhëna sipas viteve për numrin e punonjësve të policisë të referuar për ndjekje penale të ndarë sipas niveleve

vitet	Nr. Punonjësve Totali	Niveli i mesëm drejtues	Niveli i parë drejtues	Niveli zbatues
2006	254	16	89	149
2007	221	5	75	141
2008	202	3	76	123
2009	148	2	42	104
2010	145	1	34	110
2011	135	3	39	94

Grafiku me të dhëna sipas viteve për numrin e punonjësve të policisë të referuar për ndjekje penale të ndarë sipas niveleve (gradave) të punonjësve të Policisë së Shtetit.



5. TRAJTIMI I ANKESAVE TË SHTETASVE PËR PUNONJËS TË POLICISË SË SHTETIT

Gjatë vitit 2011, strukturat e SHKB-së në nivel qendror e vendor kanë kryer verifikime për **525** ankesa nga të cilat **218** janë letërankesa dhe **307** raste ankesa nëpërmjet linjës telefonike pa pagesë. Shtetasit janë ankuar tek:

- Kryeministri
- Ministri i Brendshëm
- Avokati i Popullit
- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në MB
- Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së
- Zyra e Ankesave e SHKB-së
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit
- E-mail i SHKB-së
- Linjës telefonike pa pagesë
- Strukturat e SHKB-së në qarqe

Objekti i këtyre ankesave lidhet me implikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, në veprime të kundraligjshme si: shpërdorim detyre, veprime arbitrare, qëndrime të njëanshme në zgjidhjen e konflikteve të pronësisë, gjoba të padrejta nga punonjës të policisë rrugore, tejkalim të kompetencave ligjore, etj.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i **218** letër ankesave rezulton se:

- për **130** raste të ankesave të shtetasve, nuk vërtetohet fakti se punonjësit e policisë kanë kryer shkelje ligjore në detyrë apo për shkak të saj;
- për **7** raste ankuesit gjatë procesit të verifikimit kanë heqë dorë nga ndjekja e mëtejshme me arsyetimin se janë bindur se ankesa e tyre nuk qëndron;
- për **18** raste ndaj punonjësve të policisë ka filluar një hetim administrativ nga Drejtoria e
- Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit;
- për **10** raste, ankesat e shtetasve kanë shërbyer si indicje për fillimin e një hetimi penal;
- për **11** raste, ankesat e shtetasve kanë shërbyer për fillimin e një procesi informativ;
- për **9** raste, për përgjegjësin ose jo të punonjësve të policisë pritet të shprehet Prokuroria ose Gjykata;
- për **3** raste, ankesa nuk është objekt i punës së SHKB-së por është dërguar për shqyrtim në institucionin përkatës dhe
- për **30** ankesa vazhdon procesi i shqyrtimit të tyre.



Në numrin telefonik (pa pagesë) **0800 90 90**, janë bërë 307 telefonata nga shtetas të ndryshëm, të cilët kanë denoncuar raste të korrupsionit dhe shkeljeve të ligjit të kryera nga punonjësit e policisë në detyrë dhe për shkak të saj.

Numri i telefonatave (ankesave) në linjën jeshile 0800 90 90 është rritur ndjeshëm (gjatë vitit 2010 numri ka qënë në funksionim vetëm për gjashtë muaj), gjatë vitit 2011, pas publicitet që i është bërë këtij numri nga ana jonë, nëpërmjet posterave të vendosura në Pikat e Kalimit Kufitar dhe në Drejtoritë e Policisë në Qarqe, shpëndarjes së fletëspalosjeve. Gjithashtu ky është viti i dytë që kjo linjë është vënë në funksion të plotë dhe në shërbim të qytetarëve.

Telefonatat pasi janë administruar, sipas rregullave nga strukturat e SHKB-së, i janë nështruar procesit standard të shqyrtimit. Në kuadër të këtij procesi është marrë kontakt i drejtpërdrejt me telefonuesit, ku janë sqaruar në detaje rrethanat e ankimit, janë administruar me procesverbale dokumente administrative, janë marrë deklarime, janë këqyrur e sekuestruar prova materiale, etj., duke konkluduar rast pas rasti në përgjegjësinë ose jo të punonjësve të policisë.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se për 307 telefonatat (ankesat):

- për **168** raste, ankesa e shtetasit nuk qëndron;
- për **90** raste shtetasi ka heqe dore nga ndjekja e mëtejshme e ankeses;
- për **41** raste është plotësuar formulari i ankesës dhe janë kryer hetime administrative;
- për **5** raste, telefonata ka shërbyer për fillimin e proceseve informative;
- për **2** raste, telefonata ka shërbyer për fillimin e një hetimi penal dhe
- për **1** rast, telefonata ka shërbyer për fillimin e ecurisë disiplinore për punonjësin e Policisë së Shtetit.



6. BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E STANDARDEVE PROFESIONALE NË POLICINË E SHTETIT

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm ka një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit.

SHKB-ja, në zbatim të nenit 26, pika 2 të Ligjit nr. 10002, datë 06.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme", gjatë hetimeve të kryera ka konstatuar se në 23 raste punonjesit e policisë nuk kanë konsumuar elementë të ndonjë vepre penale, por kane kryer shkelje disiplinore. Dokumentacioni i plotë për këto raste i është dërguar Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit për fillimin e ecurisë disiplinore.

Gjithashtu SHKB-ja, mbi bazë të kërkesave të Drejtorisë së Standardeve Profesionale, për **48** raste, ka dërguar informacione mbi rezultatet e hetimeve të kryera ndaj punonjësve të policisë.

Nga 71 praktika dispilinore, të evidentuara më lartë, Drejtoria e Standardeve Profesionale ka dhënë këto masa disiplinore:

- Në **22** raste **"Përjashtim nga Policia",**
- Në **20** raste **"Pezullim pa pagesë deri në 30 ditë",**
- Në **1** rast **"ulje në gradë",**
- Në **6** raste **"shtyrje e afatit të gradimit deri në 12 muaj**",
- Në **22** raste është përfunduar ecuria disiplinore pasi nuk është vërtetuar shkelje e rëndë disiplinore.



7. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INSPEKTIMEVE

Drejtoria e Inspektimeve pranë SHKB-së, për vitin 2011, sipas plan inspektimit të miratuar, ka zhvilluar inspektime në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve (DPQ), në Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM), në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore (NJRPRR), si dhe disa inspektime të tjera të pa planifikuara të diktuara nga dinamika e pun's.

Grafiku Inspektimeve për vitin 2011



Inspektime të kryera në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve (DPQ).

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Vlorë** - periudha e inspektimit 05 – 25 Janar 2011**.** Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të dy sektorëve të DPQ Vlorë".
2. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Berat** - periudha e inspektimit 05 - 25 Janar 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të dy sektorëve të DPQ Berat"**.**
3. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Fier** - periudha e inspektimit 02 – 28 Shkurt 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Strukturës së Hetimit të Krimit" dhe "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Strukturave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Personelit".
4. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Shkodër** – periudha e inspektimit 01 – 31 Mars 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Strukturës së Hetimit të Krimit" dhe "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Strukturave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Personelit".
5. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Korçë** - periudha e inspektimit 22 Qershor – 22 Korrik 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ Korçë".

6. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Elbasan** - periudha e inspektimit 01 - 30 Shtator 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ Elbasan".
7. Drejtoria e Policisë së Qarkut **Kukës** - periudha e inspektimit 02 - 30 Nëntor 2011. Objekti: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ Kukës".

Raportet e inspektimit me konstatimet dhe rekomandimet u janë dërguar Drejtorive të Policisë së Qarqeve respektive.

Konstatime:

1. Objektivat e vendosura në strategjitë një vjeçare të policimit në komunitet të DPQ-ve janë të paqarta, formale dhe të paarritshme.
2. Nuk zbatohen me përpikmëri kërkesat për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave.
3. Mungon angazhimi i nevojshëm lidhur me hetimin e ngjarjeve të vjetra.
4. Lëvizja e caktimi në detyrë i specialistëve të hetimit të krimit, si dhe transferimi i tyre bëhet i pa motivuar, pa respektuar rregulloren e personelit , pa ndonjë kriter dhe në intervale kohe të shkurtra (procesi i vlerësimit të punës nuk funksionon).
5. Konstatohet mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, pasi specialistët e hetimit të krimit nuk kontrollohen në punën e tyre për një periudhë të gjatë. Gjithashtu shefat e sektorëve dhe seksioneve nuk kryejnë punë të mirëfilltë operativo-procedurale.
6. Pavarësisht trajnimeve të vazhdueshme të kryera në strukturat e policisë, njohuritë e marra nuk kanë gjetur plotësisht zbatimin e duhur në praktikë. Një numër i konsiderueshëm punonjësish nuk kishin njohuritë e mjaftueshme mbi Procedurat Standarde të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
7. Në disa DPQ, ka mospërputhje gradë–funksion, si në pozicione të nivelit drejtues ashtu edhe të nivelit zbatues.
8. Ka nivel të ulët profesional në dokumentimin e punës në Komisariatet e Policisë.
9. Ka mungesë të koordinimit të punës me pushtetin lokal në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e dhunës në familje.
10. Kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave, në përgjithësi nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara.
11. Punonjësit e policisë nuk dorëzojnë në kohë dokumentacionin dhe pajisjet që administrojnë kur transferohen nga një strukturë policore në tjetrën.
12. Regjistrat dhe librat që mbahen nga strukturat e policisë janë të adaptuar, të vjetër dhe nuk janë në përputhje me Manualin e Procedurave Standarde të Punës në Policinë e Shtetit dhe aktet e tjera nënligjore.

Rekomandime:

1. Hartimi i Strategjive Vjetore të DPQ-ve të bëhet në bazë të studimeve dhe përcaktimit të objektivave konkretë dhe të matshëm.
2. Të zbatohen me përpikmëri kërkesat për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave.
3. Të hartohet një strategji lidhur me hetimin e ngjarjeve të vjetra.

4. Qarkullimi i specialistëve të Hetimit të Krimit të bëhet mbi bazën e një studimi paraprak mbështetur në kriteret e meritokracisë dhe nevojës duke respektuar kërkesat e shprehura në rregulloren e personelit.
5. Sistemi i kontrollit të brendshëm, të funksionojë në mënyrë të tillë që të sigurojë kontrollin dhe llogaridhënien e vazhdueshme të strukturave të PSH.
6. Punonjësit e policisë të trajnohen në vazhdimësi për njohjen e akteve që normojnë punën e tyre.
7. Shefat e Sektorëve dhe Seksioneve të mos mjaftohen thjesht me mbikqyrjen e punës së specialistëve por çështje të rëndësishme ti ndjekin vetë.
8. Të sigurohen mjete e pajisje të nevojshme në mbështetje të veprimtarisë së strukturave operacionale të policisë.
9. Të përputhen gradat me funksionet në të gjitha nivelet e Policisë së Shtetit.
10. Të rritet niveli profesional për dokumentimin e punës në komisariatet e Policisë.
11. Të njihen dhe të zbatohen me rigorozitet Procedurat Standarde të punës për Rendin dhe Sigurinë Publike, në mënyrë të veçantë në nivel komisariati.
12. Të rritet bashkëpunimi me pushtetin vendor, OJF dhe institucionet e tjera që merren me trajtimin e viktimave të dhunës në familje.
13. Të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i personave në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit në përputhje me standarte e kërkuara.
14. Shërbimet mbështetëse të marrin masa për plotësimin e nevojave me dokumente standarte (regjistra, libra, dosje, formular, etj.).

Inspektime të kryera në Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM).

1. DRKM **Korçë -** periudha e inspektimit 22 Qershor – 22 Korrik 2011.
2. DRKM **Vlorë** - periudha e inspektimit 03 - 31 Tetor 2011.
3. DRKM **Kukës -** periudha e inspektimit 02 - 30 Nëntor 2011.

Objekti i Inspektimit "Vlerësimi i kryerjes së detyrave nga DRKM". Raportet e inspektimit me konstatimet dhe rekomandimet u janë dërguar DRKM-ve respektive.

Konstatime:

1. Strategjitë një vjeçare të DRKM-ve nuk kanë gjetur implementim të plotë. Konstatohet që objektivat e vendosura në këto strategji janë të paqartë, formale dhe të paarritshëm. Kjo bën pothuajse të pamundur përcaktimin e efektivitetit dhe efiçencës së këtyre strukturave policore.
2. Nuk zbatohet me korrektësi ligji procedurial penal dhe ligji për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit, në rastet e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të tentativës për kalim të paligjshëm.
3. Ka mungesë bashkëpunimi me strukturat homologe kufitare, për sa i përket krimit ndërkufitar, lehtësimit të procedurave të hyrje-daljeve, si dhe trajtimit të personave të kthyer (Deportiv dhe INAD).
4. Nuk ka personel të mjaftueshëm për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit.

5. Në shumicën e pikave të kalimit kufitar (PKK), shërbimet e policisë kufitare operojnë në të njëjtën kabinë kontrolli me shërbimet doganore. Kjo gjendje krijon mundësi për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar.
6. Hapat procedurialë për trajtimin e personave Deportiv dhe INAD, janë të përcaktuara në akte të ndryshme. Mospërfshirja e tyre në një akt të vetem, krijon vështirësi në mbarvajtjen e punës.
7. Ka mangësi në procedurat standarde të punës, në lidhje me praktikat e personave Deportiv dhe INAD, konkretisht:
   - Praktikat për personat Deportiv dhe INAD nuk administrohen sipas rregullave të rruajtjes e administrimit të dokumenteve. Specialistët e hetimit i fillojnë procedurat direkt pa i sigluar ato nga titullari i strukturës.
   - Nuk kanë kartela shoqëruese.
   - Praktikat janë në një kopje.
8. Nuk ka një formular të miratuar, për dokumentimin e të dhënave të marra në rastin e intervistimit të personave të kategorive INAD dhe Deportiv.
9. Nuk referohen në Prokurori personat e kthyer, të cilët kanë deklaruar se kishin kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, kur vepra penale nuk i ka kaluar afatet e parashkrimit. Nuk zbatoheshin me korrektësi masat ndëshkimore administrative (gjoba) siç përcaktohet në ligjin "Për kontrollin e mbikëqyrjen e kufirit".
10. Kontrolli nga DRKM-ve i shtetasve të huaj që kanë qëndrim të parregullt në Shqipëri nuk rezulton efikas.
11. Procedura e miratimit të lejeve të qëndrimit rezulton shumë burokratike, pasi vendim-marrja bëhej nga Departamenti i Kufirit & Migracionit, pas propozimit të Drejtorisë Rajonale dhe në shumicën e rasteve tejkalohej afati 30 ditor që përcakton ligji.
12. Punonjësit DRKM-ve nuk kanë pajisje të mjaftueshme për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit. Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.

<u>Rekomandime:</u>

1. Hartimi i Strategjive Vjetore të DRKM-ve të bëhet në bazë të studimeve dhe përcaktimit të objektivave konkretë dhe të matshëm.
2. Të zbatohet me korrektësi ligji procedural penal dhe ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, në rastet e kalimit të paligjshëm dhe të tentativës për kalim të paligjshëm të kufirit.
3. Të përmirësohet bashkëpunimi me strukturat homologe kufitare, sa i përket krimit ndërkufitar, lehtësimit të procedurave të hyrje daljeve, si dhe trajtimit të personave të kthyer Deportiv dhe INAD.
4. Të shikohet mundësia për rritjen e numrit të punonjësve për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit.
5. Shërbimet e policisë kufitare të operojnë në kabina kontrolli të veçanta nga shërbimet doganore.
6. Të unifikohen në një dokument të vetëm hapat proceduralë për trajtimin e personave Deportiv dhe INAD.
7. Të përfshihen në procedurat standarde mënyra e administrimit të praktikave dokumentare për personat Deportiv dhe INAD.

8. Të miratohen formularë tip për intervistimin e personave të kategorive INAD dhe Deportiv.
9. Të kryhen të gjitha veprimet e duhura hetimore në lidhje me personat e kategorive INAD dhe Deportiv dhe nëse ka element të ndonjë vepre penale materialet të referohen në Prokurori ose në rastet e tjera të zbatohen masat ndëshkimore administrative.
10. Të forcohet bashkëpunimi me struktura të tjera të PSH-së për kontrollin e të huajve të parregullt në territorin e DRKM-ve.
11. Të lehtësohen procedurat e miratimit të lejeve të qëndrimit për të huajt.
12. Të ndërmeren masat e nevojshme për plotësimin e nevojave me pajisje (kamera termike, live skaner, pajisje të vijës së dytë të kontrollit), në çdo njësi të policisë kufitare.

Inspektime të kryera në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore (NJRPRR).

1. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Korçë** - periudha e inspektimit 22.06 - 22.07.2011.
2. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Elbasan** - periudha e inspektimit 01.09 - 30.09.2011.
3. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Vlorë** - periudha e inspektimit 03.10 - 31.10.2011.
4. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Kukës** - periudha e inspektimit 02.09 - 30.09.2011.
5. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Durrës** - periudha e inspektimit 01.12 - 15.12.2011.
6. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore **Lezhë** - periudha e inspektimit 01.12 - 15.12.2011.

Objekti i inspektimit në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore të lartpërmendura ka qënë "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR". Raportet e inspektimit me konstatimet dhe rekomandimet u janë dërguar Njësive Rajonale të Policisë Rrugore respektive.

Konstatime:

1. Si rrjedhoj e ndarjes nga DPQ-të si njësi strukturore më vete NJRPRR-të nuk kanë një strategji në nivel rajonal me objektiva të qartë dhe të matshëm për planifikimin e veprimtarisë së tyre një-vjeçare. Bashkëpunimi me strukturat e tjera të policisë në nivel vendor nuk është në nivelin e duhur.
2. Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit nuk bëhej në përputhje me Urdhrin Nr. 1284 datë 14.10.2010 "Për dokumentacionin që duhet të mbahet dhe administrohet nga personeli i policisë rrugore".
3. Nuk zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor të RSH dhe kërkesat e Udhëzimit Nr.388 datë 02.11.2010 të Ministrit të Brendshëm, "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor".
4. Nuk ka shërbime të mjaftueshme për kontrollin e akseve kryesore gjatë natës.
5. Vjelja e gjobave është në nivele të ulëta.
6. Numër relativisht i lartë aksidentesh në NJRPRR të inspektuara.
7. Mungon bashkëpunimi me komunitetin, median dhe autoritetet vendore në lidhje me edukimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor.

8. Bashkëpunimi me shërbimin postar dhe filialet e bankave të kontraktuara për arkëtimet e gjobave nuk është në nivelin e duhur.
9. Konstatohet se mandat arkëtimet e pagesave të gjobave në filialet e bankave dhe shërbimin postar nuk dorëzoheshin brenda ditës në NJRPRR. Kjo krijonte probleme për qytetaret sepse rezultonin debitor në sistem edhe pasi kishin paguar gjobën në filialet e bankave ose në shërbimin postar.
10. Vihet re një tendencë e punonjësve të policisë rrugore për të vënë gjoba për shkeljet e lehta thjesht për efekte statistikore duke toleruar shkeljet e rënda.
11. Operatorët e hedhjes së gjobave, kanë dinamikë të ngjeshur duke vonuar ofrimin e shpejtë të shërbimit ndaj qytetarëve.
12. Punonjësit e Policisë Rrugore kanë mangësi në veshje dhe mjete të nevojshme për pune (radio, radar, teste alkooli). Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.

Rekomandime:

1. Hartimi dhe miratimi i një dokumenti strategjik një vjeçar në nivel rajonal për çdo NJRPRR, si dhe rritja e bashkëpunimit me strukturat e tjera të policisë në nivel vendor.
2. Të zbatohen me korrektësi kërkesat e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1284, datë 14.10.2010 "Për dokumentacionin që duhet të mbahet dhe administrohet nga personeli i policisë rrugore".
3. Të zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor të RSH dhe Udhëzimit Nr. 388, datë 02.11.2010 i Ministrit të Brendshëm "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor".
4. Të merren masa organizative për mbulimin me shërbim gjatë natës të akseve kryesore, qoftë edhe me rialokim të burimeve njerëzore.
5. Të rritet bashkëpunimi me komunitetin, median dhe autoritetet vendore në lidhje me edukimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor.
6. Të bëhen studime profesionale për përcaktimin e shkaqeve të aksidenteve dhe marrjen e masave parandaluese për minimizimin e tyre.
7. Të përmirësohet puna e Policisë rrugore për vjeljen e plotë të gjobave.
8. Të rritet bashkëpunimi me filialet e bankave dhe shërbimet postare të kontraktuara, për rakordimin e arkëtimeve të gjobave dhe të hedhjes së tyre në kohë në sistem, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.
9. Masat e gjobave të vëna nga punonjësit e policisë rrugore të korrespondojnë me shkeljet e konstatuara në fakt. Duhet të realizohet mbikqyrja nga eprorët.
10. Të përmirësohen kushtet e punës në ambientet e policisë rrugore me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.
11. Të merren masa për kompletimin e punonjësve të policisë rrugore me mjetet e pajisjet e nevojshme të punës.

Inspektime të jashtëzakonshme.

I. Drejtoria e Inspektimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit të SHKB-së zhvilloi në **Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë** inspektimin me objekt: "Menaxhimi i situatës nga strukturat e Policisë së Shtetit, para, gjatë dhe pas demonstratës së datës 21.01.2011" – periudha e inspektimit 08.02.2011 – 08.03.2011

Raporti i inspektimit me konstatimet dhe rekomandimet i është dërguar DPPSH-së.

Konstatime:

1. Konstatohet një performancë jo e mirë e strukturave të Policisë së Shtetit, në mbledhjen e informacionit në kohë që të paraprinte marrjen e masave të duhura nga Policia e Shtetit, për përballimin e situatës së krijuar.
2. Studimi dhe rikonicjoni i terrenit përreth godinës së Kryeministrisë nuk është bërë i plotë, gjë që solli dhe mos mbulimin me shërbim policie të gjithë perimetrit të jashtëm të godinës së Kryeministrisë.
3. Nuk ka funksionuar mirë zinxhiri vertikal i komandimit nëpërmjet kanaleve të komunikimit, nga drejtuesit në bazë, madje për një periudhë të konsiderueshme nuk ka patur fare komunikim.
4. Vendosja e drejtuesve të operacionit ishte jo e drejtë, pasi ata ishin vendosur në kordonin e parë, gjë që solli kufizim të fushëpamjes duke mos arritur të kontrollohen të gjitha shërbimet e dislokuara.
5. Efektivat e Shërbimeve të Rendit dhe të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, nuk ishin të pajisura plotësisht me pajisje speciale e mjete mbrojtëse si; kaska mbrojtëse, mburoja policie, veshje për mbrojtje ndaj goditjeve me sende të forta, lëndë kimike (sprajt lotsjellës individual, granata me gaz CN, fishekë me gaz 12 mm dhe 40 mm), automjete ujëhedhës, të cilat në të tilla raste janë të domosdoshme dhe të detyrueshme për përmbushjen e detyrës.
6. Vendosja e shërbimeve të Policisë në orën 11.00, tek godina e Kryeministrisë tre orë para zhvillimit të protestës, ishte e parakohshme dhe për pasojë solli lodhjen e forcave.
7. Punonjësit e shërbimeve të rendit dhe sigurisë publike, nuk janë trajnuar për përballimin e situatave të tilla.
8. Nuk është përdoruar forca në momentin e duhur dhe në mënyrë të përshkallëzuar nga forcat e Policisë së Shtetit, madje në disa raste, sidomos gjatë shpërndarjes së protestuesve, përdorimi i mjeteve të forcës (shkopinj gome), ka qenë i panevojshëm.
9. Nuk ka rezultuar efektiv përdorimi i lëndëve lakrimogjene (gazi lotsjellës) dhe i automjeteve ujëhedhës, ndaj protestuesve.
10. Punonjësit e policisë që kishin në përdorim këto pajisje, treguan paaftësi profesionale gjatë përdorimit të tyre.

Rekomandime:

1. Të zbatohen me përpikmëri kërkesat e Ligjit Nr. 8773, datë 23.04.2011 "Për Tubimet", konkretisht:

- Struktura përkatëse policore të shprehet zyrtarisht për garantimin ose ndalimin e zhvillimit të tubimeve.
- Të caktohet punonjësi përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit.
- Të bëhen filmime dhe fotografime të sakta dhe kronologjike të zhvillimit të tubimit.

2. Të përmirësohet puna parandaluese e strukturave të Policisë së Shtetit, për:
- Marrjen e informacioneve në kohë.
- Planifikimin e forcave dhe dislokimin e tyre në bazë të informacioneve paraprake të siguruara.
- Identifikimin dhe evidentimin në kohë të personave me precedent kriminal, për të cilët ka të dhëna që mund të përfshihen në akte të dhunshme.
- Studim dhe rikonicjon i plotë i vendit ku do zhvillohet tubimi.

3. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e Strukturave të Rendit dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë me mjetet e nevojshme logjistike, për përballimin e situatave të tilla.

4. Të parashikohen trajnimet e duhura për struktura të veçanta të Policisë së Shtetit, për të përballuar situata të tilla.

5. Të hartohen plane masash me detyra të qarta dhe përgjegjësi konkrete, për gjithë punonjësit e PSH-së që angazhohen në veprimtari të tilla.

6. Të sigurohen mjete efektive dhe kanale të qarta komunikimi vertikalisht dhe horizontalisht, ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit, gjatë zhvillimit të tubimeve.

7. Të sigurohet dhe instalohet një server qendror, për regjistrimin e gjithë komunikimeve ndërmjet punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë zhvillimit të këtyre operacioneve policore.

8. Të bëhen studime të hollësishme në lidhje me ndryshimin e strukturës organike dhe rialokimin e burimeve njerëzore me qëllim rritjen e numrit të FNSH-ve, në përpjesëtim të drejtë me numrin e përgjithshëm të forcave të Policisë së Shtetit.

9. Grupet e monitorimit që parashikohen në plane masash duhet të kontrollojnë dhe drejtojnë operacione të tilla nga vendkomanda të posaçme, në mënyrë që drejtimi dhe kontrolli i situatës të jetë efektiv dhe efiçent.

10. Përdorimi i forcës duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe nuk duhet te kapërcejë kufijtë e nevojës për situatën e paraqitur.

11. Të zbatohen me rigorozitet Procedurat Standarde të Punës, në lidhje me përdorimin e pajisjeve speciale (situata e të papriturave), të përdorimit të gazit lotsjellës dhe përdorimit të automjeteve ujëhedhës.

12. Të respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, gjatë shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit.

II. Drejtoria e Inspektimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit të SHKB-së, zhvilloi në të gjithë DPQ-të, inspektimet me objekt: "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian", periudha e inspektimit 28.03.2011 – 13.04.2011.

Konstatime:

1. Ambientet e strukturave të DPQ-ve në përgjithësi nuk përmbushnin kushtet dhe kriteret për dhomat e sigurisë të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" dhe Urdhrin Nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".
2. Mungonin kushtet e higjenës personale, siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/l, të Urdhrit Nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike".
3. Në fashikullin e personave të ndaluar/arrestuar (për ato struktura ku u gjetën persona të kësaj kategorie), mungonte formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike.
4. Stafi mjekësor i DPQ-ve nuk kryente vizitën mjekësore dhe regjistrimin e të gjithë personave të ndaluar/arrestuar në regjistrin e vizitave mjekësore në dhomat e sigurisë, brenda 24 orëve të para, siç parashikohet në Kreun VI/B, pika 5/d, të Urdhrit Nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".
5. Regjistrat e personave të ndaluar apo arrestuar në shumicën e strukturave të inspektuara nuk ishin në përputhje me Urdhrin Nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" dhe Urdhrin Nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", ndërsa regjistrat e tjerë në pjesën më të madhe ishin të përshtatur nga vetë punonjësit.
6. Në regjistrin e vizitave mjekësore dhe atë të sendeve personale nuk shënoheshin të gjithë personat.
7. Në shumë komisarite policie nuk ka dhoma sigurie.
8. Infrastruktura e dhomave të shoqërimit në të gjitha strukturat nuk ishte në përputhje me kushtet e kriteret e përcaktuara në Urdhrin Nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".
9. Regjistrat e personave të shoqëruar nuk ishin në përputhje me Urdhrin Nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamenit të Sigurisë Publike" dhe Urdhrin Nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
10. Në pjesën më të madhe të strukturave gjatë plotësimit të regjistrave të shoqërimit në rubrikat ku kërkohet emri i punonjësit që ka bërë shoqërimin, përdoreshin kode policore, dhe në rubrikën "arsyeja e shoqërimit" u vërejt shpesh termi "verifikim", duke mos pasqyruar saktë arsyen e shoqërimit, si edhe konstatohen vonesa të pa justifikuara për kryerjen e veprimeve.
11. Mënyra e plotësimit dhe administrimit të formularëve të shoqërimit nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamenit të Sigurisë Publike".

Rekomandime:

1. Të merren masa nga Policia e Shtetit, për përmirësimin e kushteve të dhomave të sigurisë dhe të shoqërimit në përputhje me standartet e miratuara.
2. Të shihet mundësia e ndërtimit ose të vënies në fuksionim e të paktën 2 dhomave të sigurisë për çdo komisariat atje ku nuk ka të tilla.
3. Të njihen dhe të zbatohen me rigorozitet Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike, Manuali "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, si dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit"
4. Të unifikohen dhe standartizohen regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në të gjithë Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, sipas procedurave standarte të punës dhe Urdhrit Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
5. Të merren masa urgjente nga Komisariati i Policisë Vlorë për trajtimin me ushqim të personave të ndaluar apo arrestuar, sipas standarteve të kërkuara, duke respektuar ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
6. Të trajnohen punonjësit e shërbimit të infomacionit dhe dhomave të sigurisë, në lidhje me procedurat standarte të punës.
7. Të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duke nxjerrë akte përkatese, lidhur me zhvendosjen në kohë në vendin e vuajtjes së dënimit ose institucionin e paraburgimit, të personave të arrestuar që kanë marrë masën e sigurisë "Burg pa afat" .
8. Të unifikohet praktika, duke saktësuar dhe qartësuar në aktet përkatëse, rastet e shoqërimit të personave në polici.
9. Të merren masa për mbulimin e gjithë Drejtorive të Policisë në Qarqe, me shërbim shëndetësor, si dhe të rritet apo të përmirësohet cilësia e këtij shërbimi.

III. Drejtoria e Inspektimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit të SHKB-së zhvilloi inspektimin në **Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Tiranë dhe Njësinë Rajonale të Qarkullimit Rrugor, Tiranë,** me objekt; "Vlerësimin e procedurave të hartimit, klasifikimit, njohjes dhe zbatimit të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me Nr. 492, date 20.05.2011 "Për përgatitjen e Planit Operacional për evakuimin e personelit të KQZ-së, nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit".

IV. Drejtoria e Inspektimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit të SHKB-së zhvilloi inspektimin në **DPQ, Tiranë,** me objekt: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave në Sektorin Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në DPQ, Tiranë" – periudha e inspektimit 31.10.2011 – 05.11.2011**.**

V. Drejtoria e Inspektimit, zhvilloi në **Komisariatin e Policisë nr. 3, të DPQ, Tiranë** inspektimin me objekt: "Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Seksionit të Hetimit dhe Parandalimit të Krimit në Komisariatin e Policisë Nr. 3, në lidhje me punonjësin e policisë A.H.", i proceduar penalisht dhe i arrestuar për përfshirje në veprimtari kriminale - periudha e inspektimit 20.07.2011 – 31.07.2011.

Raportet për këto inspektime me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse janë dërguar në strukturat përkatëse Policore.

Rekomandimet e dhëna si rezultat i konkluzioneve të arritura në raporte deri në përfundim të vitit 2011, janë një bazë për veprimtarinë inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit, me synim, verifikimin e përmbushjes së tyre gjatë vitit 2012.

Në këtë mënyrë do të plotësohet praktikisht edhe cikli inspektues i ndërmarrë prej Drejtorisë të Inspektimit që nga krijimi i saj. Ky nivel i ecurisë së veprimtarisë inspektuese në të vërtetë krijon një pamje më të qartë të problemeve me të cilat përballet Policia e Shtetit dhe njëkohësisht kërkon një profesionalizëm më të madh nga ana e Drejtorisë së Inspektimit për trajtimin e tyre.

8. KONKLUZIONE

Nga analiza në tërësi e të dhënave zyrtare që administron SHKB-ja, si dhe duke u nisur nga rastet konkrete të ndjekjes dhe hetimit të korrupsionit në Policinë e Shtetit, arrijmë në këto konkluzione:

- ✓ Performanca e Policisë së Shtetit ka ardhur në rritje nga një vit në tjetrin.
- ✓ Policia e Shtetit ka përmirësuar bashkëpunimin me SHKB-në, për të luftuar korrupsionin në radhët e saj.
- ✓ Gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, SHKB-ja ka ndjekur dhe hetuar një numër më të madhë veprash korruptive.
- ✓ Pas inspektimeve në Policinë e Shtetit, rekomandimet e SHKB-së janë trajtuar nga menaxherët e Policisë së Shtetit dhe po merren masat e duhura për zbatimin e tyre.
- ✓ Megjithëse ka pasur progres, në punën e Policisë së Shtetit konstatohet se ka akoma për të bërë, sidomos në drejtim të efektivitetit, efiçencës, rritjes së transparencës dhe garantimit të drejtave dhe lirive themelore të individit, në mënyrë që të rritet besimi i publikut.

Faktorët që kanë ndikuar në përmirësimin e punës:

I. Vazhdimi i reformave të ndërmarra nga qeveria ne luftën ndaj korrupsionit dhe për një qeverisje transparente.

II. Riorganizimet strukturore që janë ndërmarrë në Policinë e Shtetit.

III. Rritja e bashkëpunimit me publikun dhe institucionet e tjera në luftën kundër korrupsionit.

IV. Mbështetja nga partneret ndërkombëtare nëpërmjet asistencës së dhëne nga misionet PAMECA, OSCE dhe programi ICITAP.

V. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën policore.

VI. Reformat që janë ndërmarrë nga SHKB-ja:

a) Hartimi e miratimi i akteve të reja normative në zbatim të Ligjit të ri të SHKB, me karakter administrativ dhe operacionale.

b) Forcimi i kapaciteteve administrative, hetimore dhe inspektuese të SHKB-së.

c) Rritja e efektivitetit të punës së SHKB-së për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit në radhët e Policisë së Shtetit.

d) Rritja e kapaciteteve profesionale, teknike dhe operacionale të SHKB-së, nëpërmjet investimeve në pajisje e teknike, si dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit.

e) Funksionimi i strukturës së re të Drejtorisë së Inspektimeve të SHKB-së.

f) Aplikimi i teknikave të posaçme për hetimin e veprave korruptive si dhe rritja e bashkëpunimit me Prokurorinë, sidomos me Njësitë e Përbashkëta Hetimore (Task Forcë).

g) Aplikimi i masave parandaluese kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit.

VII. Rritja e bashkëpunimit me publikun për marrjen dhe shqyrtimin e ankesave ndaj policisë, nëpërmjet të linjës telefonike 0800 90 90 (pa pagesë), e-mail, etj..

9. OBJEKTIVA PËR SHKB-NË

- Hartimi dhe miratimi i akteve normative në zbatim të ligjit të SHKB-së.

- Realizimi i detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2011-2013 për zbatimin e Strategjisë ndër sektoriale të luftës kundër korrupsionit.

- Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga plani i veprimit për përmbushjen e 12 rekomandimeve të opinionit të Komisionit Europian për Shqipërinë.

- Forcimi i kapaciteteve administrative, për të kontrolluar korrupsionin në Policinë e Shtetit, rritjen e efektivitetit të hetimeve penale, sidomos ndaj zyrtarëve të lartë, duke aplikuar teknika të posaçme hetimore, si dhe gjurmimin e konfiskimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga korrupsioni.

- Aplikimi i masave parandaluese, nëpërmjet bashkëpunimit me publikun, inspektimeve, përdorimit të teknikave të posaçme gjurmuese/hetimore, zhvillimit të programit të testit të integritetit, etj..

- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese si: Prokurorinë, Policinë e Shtetit, Shërbimet Informative, etj.

- Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Gjykatën për krijimin e një statistike të qëndrueshme mbi ecurinë e hetimeve dhe gjykimeve të çështjeve penale të referuara nga SHKB-ja, rekomandim ky i bërë edhe nga GRECO (Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit).

- Rritja e bashkëpunimit me homologët tanë ndërkombëtar me të cilët jemi partner në luftën ndaj korrupsionit (EPAC, RAI, etj.).

- Përmirësimi i teknologjisë në rritjen e efektivitetit të rrjeteve dhe programeve kompjuterike.

- Rritja në një nivel më të lartë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, lidhur me shkëmbimin e informacionit dhe kryerjen e inspektimeve të përbashkëta.

- Bashkëpunimi me ILDKP për rastet e hetimit të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit të drejtuesve të lartë të Policisë Shtetit, si dhe drejtuesve të tjerë që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë.
- Trajnimi i vazhdueshëm i personelit të SHKB-së, përfshirë edhe bashkëpunimin me Prokurorinë, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për Policinë Gjyqësore".
- Menaxhimi me efektivitet i buxhetit të SHKB-së.
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera, për sondazhet mbi perceptimin e publikut në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit.

10. SI DO TË MATET REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË SHKB-SË

- Nëpërmjet zhvillimit të mekanizmave të vetkontrollit dhe llogaridhënies, që përfshin:

- Nëpërmjet kontrolleve dhe analizës së realizimit të objektivave dhe detyrave të parashikuara në programin vjetor të SHKB-së për vitin 2012, të miratuar nga Ministri i Brendshëm dhe në planet e tjera të veprimit.

- Nëpërmjet vlerësimeve të punës së SHKB-së dhe të Policisë së Shtetit të shprehura në raportet e organizmave ndërkombëtarë për Shqipërinë (DASH, TIA, KE, etj.).

- Nëpërmjet treguesve statistikorë mbi ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve të referuara nga SHKB-ja pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, rasteve të dërguara në gjykatë dhe numrit të punonjësve të policisë të dënuar me vendim të formës së prerë.

- Nëpërmjet të dhënave statistikore mbi ecurinë e proceseve disiplinore ndaj punonjësve të policisë, të ndjekura nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, për rastet kur ato janë iniciuar nga SHKB-ja.

- Nëpërmjet identifikimit të masave konkrete të ndërmarra nga policia në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportet e inspektimeve të kryera nga SHKB-ja.

- Nëpërmjet krahasimit të të dhënave statistikore që lidhen me marrjen, shqyrtimin e hetimin nga SHKB-ja, të ankesave të shtetasve për punonjësit e Policisë së Shtetit.

11. Rekomandime për Policinë e Shtetit

- Përfundimi i hartimit të procedurave standarde të punës për të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit.

- Rritja e transparencës dhe respektimi i procedurave standarte të emërimit, transferimit dhe ngritjes në detyrë të personelit.

- Zhvillimi i elementëve të vetëkontrollit dhe llogaridhënies nëpërmjet ushtrimit të kompetencave verifikuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në strukturat vartëse, nëpërmjet inspektimeve, auditimeve dhe hetimeve të shkeljeve disiplinore.

- Zbatimi dhe përmirësimi i procedurave në marrjen, vlerësimin dhe hetimin e ankesave të qytetarëve ndaj policisë.

- Rritja e bashkëpunimit me SHKB-në për marrjen dhe shqyrtimin e ankesave ndaj policisë.

- Përshpejtimi i procedurave për riorganizimin e Policisë në nivel qendror e vendor duke u paraprirë nga një studim profesional e transparent që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e performancës së Policisë.

- Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me SHKB-në, për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe direktivave (urdhrave të shërbimit) etj, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që lidhen me integritetin e punonjësve të policisë.

- Rritja e kapaciteteve trajnuese për punonjësit e Policisë së Shtetit, sidomos në drejtim të luftës ndaj korrupsionit brenda organizatës dhe rritjes së aftësive profesionale hetimore.

- Të realizohet trajnim për mbikqyrjen/udhëheqjen në lidhje me etikën për punonjësit e Policisë së Shtetit nga niveli i nënkomisarit deri te niveli i lartë drejtues.

SI MUND TË NA KONTAKTONI

Adresa: Sheshi "Skënderbe", Nr.3, Tiranë.

Tel/Fax: +355 4 22 71 735 & +355 4 22 53 516

Linjë telefonike pa pagesë per ankesat **0800 90 90**

Web-site: www.moi.gov.al, ku mund të merrni informacionin e duhur dhe të plotësoni online formularin e ankesës tuaj.

E-mail: shkb@moi.gov.al, ku mund të dërgoni ankesa, informacione, etj, për shkelje të ligjit nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Zyra e Informacionit dhe Ankesave e SHKB-së në godinën e Ministrisë së Brendshme, ku mund të depozitoni ankesën tuaj duke plotësuar formularin përkatës.

Drejtoria/Sektorët e SHKB-së në Qarqe

Mund të kontaktoni drejtpërdrejt punonjësit tanë të cilët gjenden pranë çdo strukture policore në nivel qarku, si në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë.

Ankesat ndaj punonjësve të policisë mund t'i bëni edhe pranë çdo strukture të Policisë së Shtetit.

"Për më shumë Integritet, Transparencë dhe Besueshmëri"